



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
Nr. 805/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga :

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.12.2017, shqyrtoi çështjen me

Objekt:

1. Korrigjim Vendimi

Subjekte të interesuar:

Bashkia Pogradec
Lagja Nr .2, Bulevardi “Rreshit Çollaku”, Pogradec

Agjencia e Prokurimit Publik
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave, Tiranë

Operatori ekonomik “Pinderi” sh.p.k.
Korçë, Drenovë, Rruga Nacionale Korçë Ersekë, Km 4 Zona
Kadastrale 1538 Nr. I pasurisë 96/16

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Prokurimit Publik,

Vëren:

Në datën 27.12.2017 përmes Vendimit KPP 799/2017, KPP vendosi:

1. *Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Pinderi” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.*
 2. *Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Pinderi” shpk duke e kualifikuar atë.*
 3. *Autoriteti Kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
 4. *Ngarkohet Zyra e Financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Pinderi” shpk*
 5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
 6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Komisioni i Prokurimit Publik

Arsyeton:

I.1. Me nismën e vetë organit administrativ, nga Komisioni i Prokurimit Publik, konstatohet se në Vendimin KPP 799/2017, të datës 27.12.2017 në faqen 1 (një) të vendimit sipërcituar, në objektin e këtij vendimi, KPP është shprehur:

Objekt: *Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.*

I.1.2. Nga shqyrtimi i fakteve dhe rrethanave të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, objekti i ankesës është: “Shfuqizimi i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Pinderi” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 64 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe neneve 24 dhe 25 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të korrigojë objektin e ankesës të përcaktuar në faqen 1 (një) të vendimit të sipërcituar, në objektin e këtij vendimi, nga **(ishte):**

“objekt *“Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec”;*

në **(bëhet):**

“*Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Pinderi” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec”.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha